



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

---

*Ex officio*

Rasti nr. 385 /2016

**RAPORT ME REKOMANDIME**

**I AVOKATIT TË POPULLIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

**në lidhje me**

**ndryshimin dhe plotësimin e nenit 4 të Ligjit nr. 04/l-096 për ndryshimin dhe plotësimin  
e Ligjit nr. 2003/15 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë**

**Për: Z. Kadri Veseli, Kryetar, Kuvendi i Republikës së Kosovës**

Prishtinë, më 13 korrik 2018

## Qëllimi i raportit

1. Qëllimi i këtij raporti është t'i rekomandojë Kuvendit të Republikës së Kosovës ndryshimin dhe plotësimin e nenit 4, të Ligjit nr. 04/l-096, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/15, për skemën e ndihmës sociale në Kosovë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ nr. 15 / 13 qershor 2012, Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: Ligji nr. 04/l-096 ), i cili kushtëzon ndarjen e ndihmës sociale familjeve që kanë fëmijë nën moshën pesë (5) vjeçare. Ky raport arsyeton domosdoshmërinë e ndryshimit të Ligjit nr. 04/l-096, në raport me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, me fokus të veçantë në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, pasi me këtë kufizim po rëndohet edhe më shumë jeta dhe mirëqenia e qytetarëve të cilët janë në gjendje të rëndë ekonomike.
2. Raporti jep rekomandime specifike dhe konkrete lidhur me ndryshimin dhe plotësimin e nenit 4, përkatësisht paragrafit 4.5 të Ligjit nr. 04/l-096, në mënyrë që mosha e kushtëzuar pesë (5) vjeçare e fëmijës, të ngritet në 18, në pajtim me nocionin e termit “fëmijë” dhe në qëllim të përmbushjes së obligimeve Kushtetuese.

## Baza ligjore

3. Avokati i Popullit, sipas Kushtetutës të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) dhe Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 16/26 qershor 2015, Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: LAP) ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

3.1. Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike; (neni 132 paragrafi 1 i Kushtetutës)

3.2. Avokati i Popullit mund të jap rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore; (neni 135 paragrafi 3 i Kushtetutës)

3.3. (...) me iniciativën e vet (ex officio)..... nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut; (neni 16 paragrafi 4 i LAP)

3.3. të rekomandojë Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit; (neni 18 paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të LAP)

3.4. të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës; (neni 18 paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 i LAP)

3.5. t'i rekomandojë Kuvendit harmonizimin e legjislacionit me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv.

## Faktet

4. Në gusht të vitit 2007 është nxjerrë Ligji nr. 2003/15 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë, Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë/ Prishtinë: viti ii / nr. 15/01 gusht 2007 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji nr. 2003/15).
5. Në bazë të Ligjit nr. 2003/15 rregullohet skema e ndihmës sociale me qëllim të mbrojtjes dhe



përkujdesjes të familjeve të rrezikuara në aspektin social.

6. Në janar të vitit 2016 është nxjerrë Ligji nr. 04/l-096 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/15, për skemën e ndihmës sociale në Kosovë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 15 / 13 qershor 2012, Prishtinë.
7. Në bazë të Ligjit nr. 04/l-096, rregullohet skema e ndihmës sociale në Kosovë, me qëllim të mbështetjes dhe ofrimit të ndihmës së përkohshme financiare për familjet në kushte të rënda ekonomike.
8. Më 16 qershor 2016, është publikuar një artikull në gazetën ditore “Kosova Sot” ku janë përmendur disa familje nga Gjakova me rrethinë, që janë ankuar në gjendje ende më të rëndë financiare, pasi që kanë mbetur pa ndihmë sociale.
9. Me këtë dispozitë kufizuese, në veçanti janë prekur qytetarët nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Sipas rasteve të paraqitura në IAP dhe pohimeve të vet familjeve të afektuara me këtë kufizim, ka vlerësime se një kufizim i tillë thellon edhe më tepër gjendjen e rëndë, sepse këto familje në mënyrë të planifikuar çdo 5 vite lindin edhe nga një fëmijë tjetër, në mënyrë që mos t’u ndërpritet ndihma sociale.
10. Më 16 qershor 2016, Avokati i Popullit ka iniciuar hetime me iniciativën e vetë (*ex officio*) duke u bazuar në nenin 16.4 të Ligjit.

#### **Dispozitat e zbatueshme lidhur me çështjen**

11. Neni 4 i Ligjit nr. 04/l-096 ka paraparë:

*“4.1. Për të realizuar të drejtën në ndihmë sociale, të gjithë anëtarët e familjes duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës dhe t’i plotësojnë kushtet për kategorizim në njërën prej kategorive të përcaktuara me këtë ligj.*

*4.2. Përjashtimisht, shfrytëzues të ndihmës sociale, mund të jenë edhe shtetasit e huaj të cilët:*  
*a). kanë leje qëndrimi në Kosovë; b). personat në cilësinë e azilkërkuesit; c). personat në cilësinë e refugjatit; dhe d). personat të cilët gëzojnë mbrojtje të përkohshme dhe plotësuese.*

*4.3. Për njohjen e të drejtës në ndihmë sociale si dhe përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për shtetasit e huaj, sipas paragrafit 4.2. të këtij neni, Qeveria nxjerr akt nënligjor.*

*4.4. Të drejtën në ndihmë sociale në kategorinë e parë e realizon familja, në të cilën të gjithë anëtarët e familjes janë të varur sipas përkufizimit të dhënë në nenin 2 pikën 2.7 të ligjit në fuqi, dhe asnjëri prej tyre nuk është i punësuar.*

*4.5. Të drejtën në ndihmë sociale në kategorinë e dytë e realizon familja me një anëtar të familjes të aftë për punë dhe: a). me të paktën një fëmijë nën moshën pesë (5) vjeç; apo b). që kanë në përkujdesje të përhershme një jetim nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç.*

*4.6. Dispozita e paragrafit 4.5. do të modifikohet me kohë, në mënyrë që kufiri i moshës së fëmijës gradualisht të ngritet më qëllim që ky kriter të ndryshohet, i cili do të varet nga fondet e nevojshme buxhetore të vëna në dispozicion dhe do të jetë subjekt i kufizimeve fiskale.(.....).”*

12. Ndërsa sipas Ligji nr. 2003/15, neni 4 (Kriteret jo-financiare për ndihmë sociale) përcakton:  
*“4.1. Për të përfutuar ndihmën sociale, të gjithë anëtarët e familjes duhet të jenë banorë të përhershëm në Kosovë dhe t’i plotësojnë kushtet për klasifikim në njërën prej kategorive vijuese: (a) Kategoria e parë Familja në të cilën të gjithë anëtarët e familjes janë të varur sipas përkufizimit të dhënë në nenin 2 pikën 7 të këtij ligji dhe asnjëri prej tyre nuk është i*

*punësuar. (b) Kategoria e dytë Familja me një anëtar të familjes të aftë për punë dhe: (i) me të paktën një fëmijë nën moshën pesë (5) vjeç apo (ii) që kanë në përkujdesje të përhershme një jetim nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç, Të gjithë anëtarët e familjes për përfshirje në kategorinë e dytë ose duhet të jenë të varur sipas përkufizimit të nenit 2.7 të këtij ligji, ose duhet të jenë të regjistruar si të papunësuar në Zyrat e Punësimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.(...)”*

### **Instrumentet relevante ligjore**

14. Kushtetuta në nenin 21 paragrafi 1 përcakton: *“Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës”*. Kurse paragrafi 2 i këtij neni thotë: *“Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë”*.
15. Kushtetuta në nenin 22 (Zbatimi i drejtpërdrejt i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare) përcakton: *“Te drejtat dhe liritë e garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:*  
*(...)*  
*(2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj ;*  
*(...)*  
*(7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës.*  
*(...)*
16. Kushtetuta në nenin 53 (Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut) përcakton: *“Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ”*.
17. Më tutje, Kushtetuta në nenin 50 (të drejtat e fëmijës), në paragrafin 1 përcakton: *“Fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre”* Kurse paragrafi 4 i këtij neni thotë: *“Të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve”*.
18. Së fundmi, Kushtetuta në bazë të nenit 55, paragrafit 4 (Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore, theksohet: *“Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t’i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël”*, Kurse paragrafi 5 i këtij neni thotë: *“Kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrësi esencën e së drejtës së garantuar”*.
19. Konventa për të Drejtat e Fëmijës në nenin 1 përcakton: *“...me fëmijë kuptohet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeçare...”*
20. Konventa për të Drejtat e Fëmijës në nenin 3, paragrafi 1 përcakton: *“Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legislative, interesi më i lartë*



*i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese”*

21. Ligji nr.02/L-17, për Shërbime sociale dhe familjare, në nenin 1 jep definicionin e nocionit *fëmijë*, që nënkupton: *“Fëmijë nënkupton personin i cili është nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç”*.
22. Ligji nr.02/L-17, për Shërbime sociale dhe familjare në neni 9, paragrafi 9.1 përcakton: *“Në të gjitha çështjet lidhur me ofrimin e shërbimeve për fëmijë dhe familje, interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë konsiderata e parë dhe më e rëndësishme”*.
23. Ligji nr. 04/l-081, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/l-17, për shërbime sociale dhe familjare në nenin 9 paragrafi 1 përcakton: *“10.1. Interesat më të mira të fëmijës përmbushen kur nevojat e zhvillimit të tyre fizik dhe psikologjik plotësohen brenda kontekstit të familjes natyrore të tij. Të gjithë subjektet duhet të bëjnë çdo përpjekje të promovojnë, mirëqenien e fëmijës në suaza të familjeve të tyre biologjike përmes ofrimit të përkujdesjes, mbrojtjes dhe këshillimit social dhe në raste të jashtëzakonshme, asistencës materiale”* .

### **Analiza ligjore**

24. Kushtetuta e Republikës së Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj është në interes të funksionimit të shtetit të së drejtës zbatimi dhe realizimi në praktikë i këtyre të drejtave përfshirë edhe ato që parashohin mbrojtjen dhe kujdesin e domosdoshëm për mirëqenien e fëmijëve.
25. Gjithashtu është në interes të funksionimit të shtetit të së drejtës, ndërmarrja e veprimeve përkatëse nga institucionet shtetërore dhe jo shtetërore. Përkatësisht, është obligative që veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, t'i marrin në interesin më të mirë të fëmijëve, ashtu si është përcaktuar me paragrafin 4 të nenit 50.
26. Konsideratë mbizotëruese, interesave më të mirë të fëmijës, i jep edhe Konventa për të Drejtat e Fëmijës, e cila në tërë tekstin e saj ngërthen reflektimin në drejtëm të mbrojtjes së tyre. Konventa sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës është drejtpërdrejt e zbatueshme në Kosovë. Prandaj çdo veprim i organeve shtetërore duhet të jetë në pajtim të plotë me qëllimin e Konventës. Shkelja eventuale e dispozitave të kësaj Konvente paraqesin shkelje të Kushtetutës.
27. Në kuptim të pikës 24 të këtij Raporti, Marrëveshjet dhe Instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut janë të përfshira në Kushtetutë dhe kanë përparësi zbatimi në rast konflikti, krahasuar me ligjet e tjera të zbatueshme vendore. Në pajtim me nenin 22 të Kushtetutës listohen përveç tjerash edhe Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj (KEDNJ) por edhe Konventa për të Drejtat e Fëmijëve (KDF). Këto dokumente, sipas nenit 53, të Kushtetutës interpretohen në pajtim me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ).
28. Për mbrojtjen më të mirë të drejtave të fëmijëve, KDF ka paraparë dispozita që mbulojnë segmente të ndryshme të jetës së fëmijës, duke u nisur nga kujdesi prindëror, e drejta në privatësi, mbrojtja nga çdo lloj abuzimi e deri te drejtësia për të mitur, përfshirë këtu edhe të drejtën për të përfituar përkrahje shoqërore dhe masa të nevojshme.
29. Ajo që vlen të përmendet që në fillim të analizës së Konventës, në pajtim të arritjes së qëllimit të këtij Raporti, është që neni 1 i Konventës, i cili definon fëmijën si një: *“person më të ri se moshë 18 vjeçare”*.
30. Ligji nr. 2003/15, përkatësisht zbatimi i nenit 4 ka shkaktuar që shumë familje në gjendje të rëndë materiale, të mbesin edhe pa ndihmën sociale, të cilën e gëzonin deri në momentin kur



fëmija mbush pesë (5) vjeç.

31. Pavarësisht faktit që janë bërë ndryshime të nenit 4 të Ligjit nr. 2003/15, kjo në fakt nuk e ka përmirësuar gjendjen e familjeve të varfëra me vet faktin e kufizimit të moshës së fëmijëve. Për më shumë, paragrafi 4.6 i nenit 4 të Ligjit nr. 04/I-096 ka paraparë që dispozitat e nenit 4.5 të modifikohen me kohë, në mënyrë që kufiri i moshës së fëmijës gradualisht të ngritet më qëllim që ky kriter të ndryshohet, i cili do të varet nga fondet e nevojshme buxhetore të vëna në dispozicion dhe do të jetë subjekt i kufizimeve fiskale.
32. Në lidhje me këtë, më 16.06. 2016, është publikuar një artikull në gazetën ditore ‘Kosova Sot’, ku janë përmendur disa familje nga Gjakova me rrethinë, që janë ankuar në gjendje ende më të rëndë financiare tani që kanë mbetur pa ndihmë sociale. Duke marrë parasysh gjendjen jo të mirë ekonomike në Kosovë dhe vështirësitë në lidhje me punësimin, shumë familje varen nga ndihma sociale. Kushtet e përcaktuara për ndihmë sociale, me dispozitat ligjore në fuqi kanë ndikuar në keqësimin e gjendjes ekonomike të shumë familje, duke shkaktuar edhe pengesa dhe vështirësi në mirërritjen e fëmijëve dhe mirëqenien e familjeve në përgjithësi.
33. Duke pasur parasysh atë që u tha më lart, Ligji nr. 04/I-096, konkretisht neni 4 paragrafi 4.5 pika a), përtej çdo dyshimi shkel interesin më të mirë të fëmijës: *“Fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre”*. Njëherësh, dispozitat Kushtetuese, janë plotësisht në pajtim me standardet ndërkombëtare të parapara brenda Konventës për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës. Edhe pse, neni i njëjtë i Kushtetutës i referohet obligimit të organeve shtetërore të veprojnë në pajtim me interesin më të mirë të fëmijës, e njëjta është neglizhuar përmes Ligjit nr. 04/I-09. Në qoftë se fëmija definohet si qenie nën moshën 18 vjeçare, atëherë nuk mund t’i ndërpritet ndihma sociale për të cilën ka nevojë, në kohën kur mbush 5 vjet. Ligjvënësi në Ligjin nr. 04/I-096 ka implikuar pranimin e shkeljeve kushtetuese dhe interesit më të mirë të fëmijës, duke paraparë në nenin 4 paragrafin 4.6 që një kusht i tillë do të modifikohet me kohë, në mënyrë që kufiri i moshës të rritet gradualisht, që do varet nga fondet buxhetore e që në fakt do të jetë subjekt i kufizimeve fiskale. Nga kjo rrjedh që krijimi i një dispozite të tillë ka qenë rezultat i mungesës së buxhetit, që potencialisht do të definohej nën kapitullin e qëllimit legjitim, për të cilin në flet praktika e GJEDNJ-së.
34. Duke vënë theks në shkeljen e dispozitave kushtetuese përmes dispozitave ligjore të Ligjit nr. 04/I-096, duhet t’i referohemi edhe njëherë Konventës për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, tani që është elaboruar fuqia juridike e të njëjtës mbi legjislacionin vendor. Neni 26 i kësaj Konvente, që i referohet ndihmës sociale, shprehimisht thotë që: *“Fëmijët – përmes kujdestarëve të tyre ligjorë apo në mënyrë direkte – gëzojnë të drejtën e ndihmës nga qeveria në qoftë se janë të varfër apo kanë nevojë për ndihmë të tillë”*. Në lidhje me këtë është edhe neni pasues, që i referohet standardit adekuat të jetesës së fëmijës. Ndërsa neni 27 thekson që fëmijëve duhet njohur e drejta për një standard të jetesës që është i mjaftueshëm për t’i përmbushur nevojat e tyre fizike dhe mentale, dhe se qeveritë duhet të ndihmojnë familjet dhe kujdestarët, që nuk mund të përmbushin këto nevoja, në veçanti në lidhje me ushqimin, veshjen dhe banimin. Theksi patjetër duhet të jetë te fëmijët dhe faktit që nocioni i njëjtë u referohet të gjithë atyre që nuk kanë arritur moshën 18 vjeçare. Kushtet e parapara në Konventën për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës në lidhje me arritjen e standardit adekuat të jetesës, vlejnë edhe për fëmijë mbi moshën 5 vjeçare, në këtë rast të arritur përmes ndarjes së ndihmës për prindërit e tyre apo kujdestarët ligjor.
35. Mungesa e ndihmës sociale për fëmijë dhe familje në nevojë, kushtëzon dhe ndikon në shëndetin fizik dhe mental të fëmijës, si dhe në edukimin e zhvillimin e mëtutjeshëm të tij. Në lidhje me këtë dhe nëse merret parasysh fakti që fëmijës i ndërpritet ndihma për të cilën ka nevojë të rritet në pajtim me standardin adekuat, për të cilin plotëson kushtet në bazë të moshës deri në kohën kur mbush 18 vjet, shtrohet pyetja a mund të konsiderohet ndihma



sociale, konkretisht tërheqja prapa e së njëjtës, pasi fëmija të mbush 5 vjet, shkelje e të drejtës në pronë, sidomos duke marrë parasysh që praktika e GJEDNJ nuk njeh të drejtën në pronën që mund të fitohet në të ardhmen.

36. Të drejtat pensionale dhe benefitet tjera sociale janë paraparë me praktikën e GJEDNJ si pjesë e pronës, apo segmente që mbërthehen me nenin 1 të Protokollit Nr.1 të KEDNJ. Ashtu siç shihet nga Müller v Austria<sup>1</sup>, *e drejta pronësore të pranohet benefiti nga skema sociale e obligueshme apo vullnetare mund të ekzistojë, në qoftë se kërkuesi plotëson kushtet që parashihen me paragrafin e dytë të nenit 1 të Protokollit Nr.1. Sidoqoftë, kjo e drejtë nuk i jep kërkuesit të drejtë të kërkojë shumë të caktuar të pensionit.*<sup>2</sup> Paragrafi i dytë të cilit i është referuar këtu thërret në pengesën e të drejtës në pronë në rast të interesit publik dhe në pajtim me kushtet e parapara me ligj apo parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare publike.
37. Në lidhje me atë që u tha më lart, interferimi me të drejtën e pronës nuk duhet vetëm të ketë objektiv legjitim. Duhet po ashtu të jetë proporcional. Në Sporrong and Lönnroth v Sëeeden<sup>3</sup>, GJEDNJ ka ardhur deri tek përfundimi në lidhje me arsyetimin e interferencës: *Gjykata duhet të determinojë ekzistencën e balancës së drejtë ndërmjet interesit të përgjithshëm të bashkësisë dhe kërkesave për mbrojtje të të drejtave fundamentale të individit.* Prandaj, është më se e rëndësishme të përcaktohet *balansi* ndërmjet kufizimit të së drejtës me kërkesat e interesit të përgjithshëm. *Balansi i drejtë* nuk mund të ekzistojë atëherë kur mbajtësi i pronës duhet të durojë *“barrë individuale të tepërt”*.
38. Për më tepër, interferenca me pronën i nënshtrohet edhe kërkesës së sigurisë juridike apo legalitetit, gjë që rrjedh nga paragrafi i dytë i nenit 1 të Protokollit Nr.1 të KEDNJ: *“ndërhyrja në të drejtën e pronës duhet të jetë paraparë me kushte të përcaktuara me ligj”*. Parimi i sigurisë juridike kërkon ekzistencën dhe pajtimin me dispozitat ligjore vendore të qasshme lehtë dhe mjaftueshëm precize.<sup>4</sup> KEDNJ kërkon që edhe ligji vetë të jetë në pajtim me elementet esenciale të “ligjit”. Kjo nënkupton procedurë të drejtë, ekzekutimin e masave përkatëse nga ana e autoritetit të duhur dhe mungesën e arbitraritetit.
39. Rrjedhimisht, kushtëzimi i ndihmës sociale të dhënë nga shteti, familjeve të cilat atë duhet ta gëzojnë me qëllim të rritjes së fëmijëve të tyre, e që është në pajtim të plotë me interesin më të mirë të fëmijës, (personit që ka mbushur pesë (5) vjet, por që në bazë të Konventës për mbrojtjen më të mirë të fëmijës dhe ligjeve vendore është ende fëmijë pasi që nuk ka mbushur tetëmbëdhjetë (18) vjet). Kjo ndihmë mund të konsiderohet pronë pasi që familja në këtë rast, në të gëzon çdo të drejtë, dhe nuk llogaritet në diçka që mund t’i përkasë në të ardhmen, nuk mund të mos konsiderohet shkelje e së drejtës në pronë, në bazë të praktikës së GJEDNJ. Duke thënë këtë, duhet t’i referohemi interesit të përgjithshëm legjitim që mund të ketë shteti tek kufizimi i të drejtave elementare. Mbatja e familjeve në skamje të thellë, nga e cila kufizohet fëmija që të gëzojë gjëra elementare për rritje sa më të mirë, për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore, nuk mund të konsiderohet qëllim legjitim. Po ashtu, pa marrë parasysh që dispozitat e Ligjit janë të qarta në këtë drejtim, ato janë arbitrare, në kundërshtim të plotë me standardet ndërkombëtare dhe njëkohësisht me Kushtetutën, si aktin

<sup>1</sup> Müller v Austria, vendim i datës 16 dhjetor 1974, gjetur në: [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-75078"\]}";](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

<sup>2</sup> Dumanovski v the former Yugoslav Republic of Macedonia, vendimi i datës 3 korrik 2006, gjetur në: [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"fulltext":\["CASE OF DUMANOVSKI v. \\", "documentcollectionid2":\["GRANDCHAMBER", "CHAMBER"\], "itemid":\["001-71558"\]}";](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

<sup>3</sup> Sporrong and Lönnroth v Sëeeden, vendim i datës 23 shtator 1982, gjetur në: [http://ëeb.changenet.sk/aa/files/207e345aa907113543b0857cd6856c71/a52\\_1982\\_eu\\_sud\\_case\\_of\\_sporrong\\_and\\_lonnroth\\_vs\\_sëeeden.pdf](http://ëeb.changenet.sk/aa/files/207e345aa907113543b0857cd6856c71/a52_1982_eu_sud_case_of_sporrong_and_lonnroth_vs_sëeeden.pdf);

<sup>4</sup> Monica Carss-Frisk: A guide to implementation of Article 1 of Protocol No.1 of European Convention on Human Rights, Council of Europe, 2001, fq.9

më të lartë juridik në vend.

40. Për këto arsye, Avokati i Popullit në pajtim me gjetjet e lartcekura konstaton se: neni 4 i Ligjit nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë është në kundërshtim me Konventën për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës e cila është drejtpërdrejtë e zbatueshme në Republikën e Kosovës.
41. Avokati i Popullit, bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës *“Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore”*. Sipas kuptimit të nenit 18, paragrafi 1.2 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit ka përgjegjësi *“të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi [...]”* (neni 18, paragrafi 1.7 të LAP). Rrjedhimisht, Avokati i Popullit,

## REKOMANDON

**Ndryshimin e nenit 4, paragrafi 5 të Ligjit nr. 04/I-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë, në mënyrë që kufizimi i moshës e pesë (5) vjeçare të fëmijës, të ngritet në moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare, në pajtim me nocionin e termit “fëmijë” dhe në qëllim të përmbushjes së obligimeve Kushtetuese.**

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 28 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, luteni që brenda afatit tridhjetë (30) ditor të na njoftoni për veprimet që do të ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

  
Me nderime,  
Hilmi Jashari  
Avokat i Popullit